



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ 2022

RAPORT

PËR TRANSPARENCËN DHE KONSULTIMET PUBLIKE TË KB PËR v.2021

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli i bashkisë si organ përfaqësues, vendimarrës dhe mbikqyrës ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, të transparencës, për të qenë sa më pranë qytetarëve. Këshilli bashkisë ka privilegjin të dëgjojë dhe të vendos në emër të komunitetit

Për tu njohur me veprimtarinë e këshillit të bashkisë për vitin 2021, është e nevojshme që këshilli të marrë vendime të drejta dhe në dobi të atyre që përfaqëson. Kjo sigurisht realizohet kur vendimmarrja kalon nëpërmjet konsultimeve me qytetarët. Ligji 146/2014 në nenin 4 përcakton se cilat janë aktet që përjashtohen nga konsultimi publik. Këshilltarët duhet të njihen me çështjet që përjashtohen nga konsultimi publik siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet 2 palëshe midis shteteve, aktet administrative individuale dhe aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuara nga KM. Aktet e tjera sipas nenit 18 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore janë të detyrueshme për konsultim publik”.

Gjatë vitit 2021 këshilli i bashkisë Elbasan ka miratuar gjithsej 140 vendime, ku asnjë nuk është kundërshtuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut. Kjo flet për përgatitje dhe nivel të lartë përgjegjësie dhe profesionalizmi si nga administrata por veçanërisht edhe nga këshilli i bashkisë. Në vendimet e marra mbizotërojnë temat sociale për të cilat janë marrë 46 vendime për çështjet me karakter financiar janë marrë 47 vendime. Për infrastrukturën janë marrë 2 vendime, për problemet urbane dhe pronat janë marrë 26 vendime, për emergjencat civile janë marrë 4 vendime si dhe 15 vendime janë marrë për probleme të arsimit, kulturës, pastrimit, gjelbërimit etj.

Bazuar në pikën 1 neni 16 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Neni 20, si dhe neni 152 i rregullores së këshillit bashkiak

Adresa:

V.K.B. Nr.18.date22.04.2020 ,“Kapitulli i Konsultimeve me Publikun”, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 3 dëgjesa publike: Per PBA 2022-2024; Per taksat dhe tarifat vendore, Per buxhetin e vitit 2022.

Nga rekomandimet e bëra janë marrë parasysh shume prej tyre qe jane perkthyer ne investime konkrete si psh për rehabilitim shkollash dhe asfaltim të disa akseve rrugore në qytet ,reabilitimi dhe riasfaltimi i në lagjen Nr.4, siç janë “Shkolla “Bardhyl Popa” rrugët “Vasil Taja”, “Ymer Stringa”, “Mithat Stringa”, “Ismail Haxhimusaj” , të cilat janë pjesë e investimeve që bashkia ka arritur të përfundojë Në rikonstruksion janë në Lagjen nr. 2 rruga “Abdyl Kajanaku”, “Nikolla Puka”, “Demir Bungo”, “Mehmet Bajraktari”, “Sul Papri” , rikonstruksion rrugësh dhe kanalizimesh edhe në rrugën “Abdyl Frashëri” në Lagjen nr.3

Asfaltim i rrugës në Kishën e Shelcanit, asfaltimi i rrugës së varrezave, ndërtimi i shkollës së re në Mlizë, ndërtimi i urës së Polisit, si dhe ngritja e Qendrën Komunitare Multifunksionale janë disa nga investimet e kryera në Shushicë dhe fshatrat përreth gjatë këtij viti.

Kërkesa për ujë të pishëm prej kohesh ka marre vemendjen e KB dhe ka zgjidhur problemin për Ujësjellësin e Kuqanit, dhe Bashkia do të vazhdojë me të gjithë pjesën e sistemit . Po ashtu ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimeve në lagjen “Emin Matraxhiu”

Nga kërkesat e bëra nuk janë marrë parasysh disa investime, por për mosrealizimin e këtyre rekomandimeve shkak ka qenë mungesa e fondeve nga ana e bashkisë . Administrata është në kërkim të realizimit të tyre me fonde jashtë bashkisë.

Gjithashtu pervec ketyre nderhyrjeve ne kemi miratuar nisjen e procedurave për marrjen me qira të një ambjenti, që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë me një fond deri në 50 000 lekë/muaj”

Një punë e lavdërueshme e këshillit të bashkisë për nxitjen e vërejtjeve dhe ankesave të qytetarëve për qeverisjen vendore ka qënë .

Vetëm kërkesa dhe ankesa nga qytetarët Elbasanit për muajt janar –dhjetor 2021 kanë qerë 10 prej të cilave 5 u është kthyer përgjigje me shkrim (janw marre vendime nga keshilli bashkiak) ndërsa pjesa tjetër (eshte ne proces) kanë marrë përgjigje me me gojë ose me telefon nga specialistët e këshillit dhe veçanërisht nga drejtorët e drejtorive.

Bashkëpunimi me struktura të tjera komunitare ka mundur për herë të parë në këshill të rregjistrohen 2 peticione prej të cilave te dyja jane ne proces.

Nga puna cilësore e këshillit vlen të përmendet veçanërisht komisioni i i kërkesave dhe peticioneve të cilët kanë vendosur afishe me emrat e tyre ,nr e cel dhe email në cdo rajon dhe njësi administrative duke komunikuar direkt me qytetarët sidomos në fillimet e pandemisë por edhe për kërkesa dhe shqetësime të tjera të komunitetit.

Nga konsultimet publike ka pasur një pjesëmarrje rreth 1237 qytetarë ku rreth 30 përqind e tyre kanë qenë vajza dhe gra.

Gjate ketij viti me ndihmen dhe mbështetjen e Bashkive te forta arritem qe te ndertojme dhe te plotesojme faqen e web te keshillit. Gjithashtu kemi bere aktive faqen e facebook duke shtuar ndjekesit. Por krahas punës së lavdërueshme të këshillit me miratimin e strategjisë së komunikimit, pasqyrimin e njoftimeve të ndryshme, rendet e ditës dhe projektakteve në internet, mbetet shumë për të bërë në vlerësimin e mendimit komunitar.

Së pari duhet të behet tradite që para miratimit të një akti në këshill të bëhen konsultime publike jo vetëm mbi bazë njësie administrative,por edhe mbi bazë profesionesh. Kjo do të thotë që sipas ndarjes së këshilltarëve mbi bazë rajonesh apo njësie të kenë të evidentuara sa inxhinjerë ndërtimi, mekanikë, gjeologë, agronomë, veterinerëtj janë në secilën prej tyre. Mbi këtë bazë nëse në mbledhje në rend dite do të kemi një problem urbanistik të mblidhen artiktët dhe këshilltarët në vendimarrje të kenë parasysh edhe mendimin e tyre etj.

Duhet te punohet me shume per te rritur numrin e ankesave dhe kerkesave qe i vijne keshillit bashkiak nga komuniteti.

Duhet te behen me aktive strukturat komunitare pasi ato jane struktura te ngritura dhe duhet te behen aktive për zgjidhjen e shqetësimeve në komunitet.

Konsultimet online ,sondazhet, pyetsorët ,vlerësimet dhe votimet online duhet të zhvillohen nëpërmjet rjeteve sociale për shumë tema që shqetësojnë qytetarët.

Sekretari i KB

Klajdi GRIPSHI

Kryetari i KB

Hektor ÇIFTJA